

Plaku Sofroni



KAPITUL SHPIRTERORE

Të dashur vëllezër dhe motrat e mia, hapeni zemrën tuaj, që Shpirti i shenjtë aty ta gdhendë modelin e Krishtit. Atëherë me ngadalë do të bëheni të aftë të pranoni në veten tuaj gëzimin dhe dhembjen, vdekjen dhe ringjalljen.

Në botë nuk ka asgjë më fisnike se thirja për të qenë të krishterë. Por sa më i lartë është qëllimi, aq më e vështirë është realizimi i tij.

Vështroheni pamjen e mrekullueshme që Zoti na e dha kur e krijoi botën, duke e formuar njeriun *sipas modelit dhe pamjes së tij*. Ajo për të cilën kemi nevojë nuk gjendet në jetën tonë të vogël të përditshme. Kërkojmë të jemi me Zotin, që të fitojmë në vetvete jetën me gjithë përmasat e saj kozmike dhe gjerësinë hyjnore.

Në vëzhgimin tonë shpirtëror, duhet ta bashkojmë kozmiken me Qenien hyjnore, të krijuarën dhe të pakrijuarën.

Në fillim ishte Fjala. Pa atë ësgjë nuk ekziston. Cdo ditë e ndiejmë jetën e sëmurë dhe të mjeruar të trupit tonë. Dhe përsëri, jemi të krijuar sipas modelit të Krishtit, Të gjithëfuqishmit. Problemi, sekreti i jetës sonë është në kalimin prej relatives drej Apsolutes. Në qoftë se qenia është krijuar prej Zotit nuk duhet të vdesë. Zoti e krijoi jetën, nuk e krijoi vdekjen. Qëllimi ynë është jeta tek Jezu Krishti, në pavdekshmëri, në përjetësi. Në përputhje me Zbulimin, është e mundur përjetësia e Zotit të na jepet.

Duhet të synojmë drejt Vetë Zotit, drejt Personalitetit të tij, do me thënë, drejt asaj që është mbi gjithcka, që t'i mundësojmë trupit tonë, ndryshe i prirë drejt mosveprimit, hov drejt përjetësisë.

Cfarë të bëjmë për shpëtimin tonë. Si ta bëjmë të pavdekshëm trupin tonë, të clirohemi prej shtetit të mëkatit dhe pushtetit të vdekjes? Ky duhet të jetë preokupimi ynë në cdo moment, dhe në të njëjtën kohë me e fortë, më e theksuar. Jeta është kaq e shkurtër, qëllimi është kaq i lartë, por edhe kaq i largët.

Sipas Kishës Orthodhokse shpëtimi i njeriut është në adhurimin e tij.

Duhet të mësojmë ta jetojmë jetën e përjetëshme të Vetë Zotit. Cdo të thotë *adhurim* i njeriut? Të jetojmë sic jetonte Zoti, t'i fitojmë mendimet dhe ndjenjat e Krishtit, para së gjithash, të momenteve të fundit të jetës së Tij tokësore.

Pas rënies, njeriu u bë fushë luftimi midis Zotit dhe armikut.

Farën që e mbolli Djalli në zemrën dhe mendjen e Adamit - mendimi të bëhet zot pa Zot - është hedhur kaq thellë në qenien tonë, saqë pandërprerë gjendemi nën pushtetin e mëkatit.

Që prej lindjes sonë bëhemi pasardhës së Adamit. Mund ta jetojmë gjendjen e rënies, e cila është një largim i tmerrshëm prej dashurisë së Atit, si i vetmi realitet i qenies njerëzore. Në botë jetojmë në atmosferën e adhurimit të rënies. Jetojmë në luks dhe shpesh herë kemi turp ta rrëfejme fenë tonë, të themi se jemi kristianë.

Mos kini besim të madh në arsimin e lartë të cilin e fitoni në botë. Civilizimi në të cilin jetojmë është kultura e rënies.

Pas dy luftrave botërore - luftra janë par excellence mëkat, njeriu modern e humbet bekimin e Shpirtit të shenjtë. Pa Shpirtin e Shenjtë, prapë, nuk mund ta kuptojmë Hyjnësinë e Krishtit. Të besojmë se ky njeri i cili është i vërtetë, është Krijues i botës, i kalon mundësitë tona. Të besojmë se Vetë Zoti u inkarnua, dhe na thërriti të jemi me të në përjetësi, ja pra kjo është ajo që ju mungon shumë vetëve, sidomos të mësuarve.

Çdo të thotë shpëtim? A është vdekja e trupit hipotezë për hyrjen në Mbretërinë e Krishtit? Si mund të zhvillojmë aftësinë tonë për të jetuar në përputhmëri me porositë e Krishtit, në përputhje me Shpirtin e Shenjtë? Vetëm një gjë është e rëndësishme: Ta ruajmë intesitetin e lutjeve dhe të pendimit. Atëherë, vdekja nuk do të jetë rënie, por kalim në Mbretërinë, për të cilën do të jemi të përgatitur nëpërmjet kungimit me Trupin dhe Gjakun e Krishtit, nëpërmjet lutjeve dhe duke e thirrur Emrin e Tij: *Zoti Jezu Krisht, Perëndia jonë, mëshirona ne dhe Botën tënde.*

E pres ringjalljen e të vdekurve dhe jetën në shekullin e ardhshëm. Çdo të thotë ky paragraf i fundit i Simbolit të Besimit? Nuk mund të durojmë mendimin për jetën e përjetshme, në qoftë se vetë përjetësia nuk hyn tek ne!

Zoti nuk e krijoi vdekjen! Në qoftë se Zoti, siç thotë Krishti, është me të vërtetë Zoti i Avraamit, i Isaakut dhe i Jakovit, atëherë ata nuk kanë vdekur. Për Zotin ata janë të gjallë.

Ligeshtim, etimologjikisht do të thotë mungesë e kujdesit për shpëtim. Përveç disave, përjashtime të vogla, i gjithë njerëzimi jeton në gjendjen e *ligështimit*. Njerëzit u bënë të papërgjegjshëm për shpëtimin e tyre. Nuk e kërkojnë jetën hyjnore. Kufizohen në kornizat e trupit, në nevojat e jetës së përditshme, në pasionet e botës dhe në veprat kompromisëse. Megjithatë, Zoti na krijoi sipas modelit dhe pamjes së Tij. Në qoftë se ky zbulim është i vertete, mungesa e kujdesit për shpëtim nuk është asgjë tjetër veçse vdekje e personalitetit.

Humbja e shpresës është humbje e vetëdijës se Zoti do të na japë jetë të përjetshme. Bota nuk jeton me shpresë. Njerëzit vetë janë dënuar me vdekje. Duhet të luftojmë ballë për ballë me ligështimin.

Jeta e botës është e konstruktuar rreth disa pasioneve njerëzore, ndërsa jeta shpirtërore gjendet në periferi. Jemi të detyruar të bëjmë kthesë të kësaj gjendjeje të gjërave, ta vendosim shpirtëroren në zemrën e jetës sonë.

Urtësia shenjtërore nuk mund ta shpëtojë botën. Kuvendet, qeveritë, organizatat e shumta të shteteve moderne më të zhvilluara të botës janë të pafuqishme. Njerëzimi vuan në mënyrë të pakufizuar. Dalja e vetme është ta gjejmë urtësinë Brenda tek ne, zgjidhjen të mos jetojmë në përputhje me idetë tokësore, por ta ndjekim Krishtin.

Si mund ta gjejmë rrugën e vet? Sipas Ungjillit, Krishti është *rruga jonë!*

Është e rëndësishme njohuria se Krishti është Perëndi. Ai i cili E do do të jetë përjetësisht pranë tij, aty ku është Ai.

Ku është shpirti ynë? Në qoftë se duam të jemi me Krishtin, me Fjalën e Perëndisë, të Cilit Ati në fillim ia dha të gjitha ato që ekzistojnë tek përjetësia duhet ta shikojmë si Njeri Perëndi në qoftë se e vëzhgojmë si Perëndi, Ai është Perëndi e përkryer. Në qoftë se e shikojmë njeri, Ai është njeri i përkryer. Urtësia, qetësia, jeta, drita e përjetëshme, gjithçka është tek Ai.

Çdo hap i jetës sonë është i pandashëm prej dogmave bazë të fesë sonë.

na albanski: Jordana Shemko